

VENDIM
Nr. 34, datë 20.1.2016

PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, PA SHPËRBLIM, TË NJË SIPËRFAQEJE PREJ 871 M², NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË AUTORITETIT SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR (ASIG), PROJEKTIT “INNOVATION HUB”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 901 e vijues të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie në përdorim, pa shpërblim, të sipërfaqes prej 871 (tetëqind e shtatëdhjetë e një) m², të mjediseve të katit të dytë të ndërtesës “Godina e Inovacionit”, me numër pasurie 1/12, zona kadastrale 8160, rruga “Papa Gjon Pali”, nr. 3, në përgjegjësi administrimi të Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), projektit “Innovation Hub” për një afat prej 3 vitesh, sipas planimetrisë dhënë në aneksin 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Autorizohet Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor që të lidhë aktmarrëveshje me projektin “Innovation Hub”, për marrjen përsipër nga ASIG-u të mbulimit të shpenzimeve për shërbimet e nevojshme, që i nevojiten projektit “Innovation Hub”, në këto ambiente.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



